



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 90 datë 25-09- 2025

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË
DATËS 29 GUSHT 2025**

Këshilli i Bashkisë Korçë në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi lexoi proces verbalin e zbardhur nga Sekretarja e Këshillit të mbledhjes të datës 29.08..2025 në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” neni 53, pika 8 dhe neni 54, gërma k) si dhe neni 92 e Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr. 80, datë 30.07.2020;

VENDOSI

1. Të miratojë procesverbalin e mbledhjes të Këshillit të Bashkisë Korçë, të datës 29 gusht 2025 bashkangjitur.
2. Kopja e proces verbalit të miratuar administrohet nga Sekretarja e Këshillit sipas procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

Miratuar me 28 vota
Vota Pro 28
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur më datë 25-09-2025

K R Y E T A R E

Ana VERUSHI



-PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 29 GUSHT 2025

Kryesuesi I mbledhjes është: Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 12:00

Zhvillimi i mbledhjes: Në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 27

Sekretari i Këshillit deklaroi kourumin prej këshilltarësh: 27

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë Sotirag Filo dhe drejtorë të administratës.

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 2

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mirëdita të gjithëve, fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak për shkak të një muaji pushimesh nuk pati rakordim të anëtarëve të kryesisë për të qënë në mbledhjen e kryesisë, po e hedh për miratim në mbledhjen e Këshillit me dy ndryshime. Së pari sepse është paraqitur me vonesë kërkesa e dorëheqjes së Këshilltarit Kreka dhe së dyti ekzekutivi ka kërkuar heqjen nga rendi i ditës i pikës 9 dhe argumentin për këtë çështje do e bëjë ekzekutivi.

Këshilltar E.Bregu: Përshëndetje të gjithëve, nuk është hera e parë që ne e kemi kërkuar në mënyrë shkresore por edhe live në mbledhje, kemi kërkuar për disa informacione ku Bashkia ka akses dhe duhet të na i kishte sjellë prej 1 viti e ca, siç bëhet fjalë për ekipin e futbollit "Skënderbeu", Bashkia Korçë është aksionere atje dhe shumë herë na është premtuar se do sjellë gjithë informacion, çfarë pjesë aksionesh ka, dokumentacionin ligjor, pasqyrat financiare apo çdo lloj dokumenti të rëndësishëm lidhur me këtë institucion, të njëjtën gjë kemi kërkuar edhe për ujësjellësin e Korçës për disa periudha, kemi kërkuar edhe ngritjen e komisionit të përkohshëm që ka të bëjë mbi një kontroll të KLSH, bëhet fjalë për një raport të vitit 2022 dhe nëse ka dalë raporti tjetër, mund të shtojë objekt edhe raporti tjetër dhe kjo çështje ka mbetur pezull dhe ndoshta duhet futur në procedurë, për tu miratuar apo rëzuar. Ndaj pyetja ime është, a është e drejtë që ne ta kërkojmë këtë apo unë e kam kuptuar gabim dhe po e kërkoj gabimisht në seancë këtë, ndaj do e kërkoja nga ju znj.kryetare e seancës që të na përgjigjeni për këtë çështje, e kemi ne gabim që e kërkojmë, apo jeni ju gabim që nuk po i jepni drejtim kësaj çështje?

Faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, meqënëse e keni adresuar drejt meje, më pas pastaj nëse ka diçka mund të përgjigjet edhe ekzekutivi, flas për këtë herë ku mbledhja e kryesisë nuk u zhvillua dhe unë e vetme nuk kam tagrin të marr vendime në lidhje me çdo lloj kërkesë që paraqesin këshilltarët në Këshillin Bashkiak, për këtë herë kjo është arsyeja për herët e tjera çdo këshilltar ka të drejtë të kërkoj informacion, dyert e ekzekutivit janë të hapura dhe çdo drejtori është e detyruar kur një këshilltar ka një kërkesë të caktuar t'i përgjigjet këshilltarit. Meqënëse jemi tek rendi i ditës, e hedhim në votim kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltare A.Taho: Për muajin korrik kemi 43 familje përfituese për programin nga dhënia e ndihmës ekonomike 6% e fondit të kushtëzuar po për këtë muaj janë 17 familje që përfitojnë kompensim të energjisë elektrike dhe përfitojnë ndihmë nga fondi i buxhetit vendor 16 familje. Komisioni u mbledh ditën e martë dhe vendosi t'ja kalojë këshillit për miratim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka pyetje?

Këshilltar E.Bregu: Në lidhje me ndihmën ekonomike por unë do e lidhja pak edhe me subvencionin e qirasë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Të vemë tek ajo pikë dhe mund ta merrni fjalën për pyetje.

Këshilltar E.Bregu: Diskutimi i përket të njëjtës çështje, tek kriteret e vlerësimit e kemi diskutuar dhe herë të tjera që familjet që kanë statusin e të përndjekurit nuk trajtohen sipas vendimit të qeverisë, prej 35 vitesh nuk është bërë pothuajse asgjë në lidhje me këtë shtresë dhe është e nevojshme kjo të merret në konsideratë, meqenëse Bashkia thotë unë kam ligjin i cili ka erdhur nga organet e qeverisjes jovendore dhe është i detyruar ta zbatojë, ndoshta Bashkia duhet të marrë në konsideratë pasi këto lloj shtresash nuk mund të lihen të harruara, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit për sygjerimin, nëse nuk ka diçka tjetër e hedhim në votim?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 27 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 5 e rendit të ditës.

“MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA.”

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltare A.Taho: Për sa i përket bonusit të strehimit në materialin e paraqitur nga drejtoria janë dy familje që plotësojnë të gjitha kriteret por ka edhe familje të tjera të cilat janë në pritje të dokumentacionit dhe këtë material vendosi t'ja kalojë Këshillit për miratim.

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 26 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Pika 7 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK SI SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA MIDIS NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË PËR RRITJEN E KAPACITETEVE TË QEVERISJES VENDORE, AKADEMI E TRAJNIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (TALGA)”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni nëse është mbledhur, nëse jo ju lutem ekzekutivi një sqarim më të plotë.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Atëherë Akademia e Trajnimit të Vetëqeverisjes Vendore do të krijojë si një subjekt të kompetencave të përbashkëta midis Bashkive, Këshillave të Qareve dhe Pushtetit Vendor. Objekti i veprimtarisë të kësaj Akademie është aftësimi cilësor dhe i vazhdueshëm i të zgjedhurve, i nënpunësve civile dhe punojësve të tjerë të njësive të vetqeverisjes vendore, ka gjithashtu kualifikimin profesional që nxit qeverisjen e mirë dhe fuqëzimin e vazhdueshme të qeverisjes vendore. Organet janë Asambleja e Përgjithshme e cila bëhet nga kryetarët e bashkive, nga kryetarët e qarqeve dhe nga ministri i pushtetit vendor si përfaqësues të ministrave, ka komunitetin drejtues të përbërë nga 11 anëtarë ku 5 janë nga qeverisja qendrore dhe 5 nga qeverisja vendore, gjithashtu edhe 1 përfaqësues nga Universiteti i Tiranës, përfaqësuesit e qeverisjes qendrore janë ministri i pushtetit vendor, një përfaqësues për vetqeverisjen vendore dhe përfaqësuesi i departamentit të administratës publike, një përfaqësues i Shkollës Shqiptare të Trajnimit të Administratës Publike dhe një përfaqësues i Ministrisë të Financave, ndërsa nga qeverisja vendore do të jetë një kryetar bashkie i bashkive me shumicë, një kryetar bashkie i pakicës qeverisëse dhe një përfaqësues i qarkut, drejtori ekzekutiv i shoqatës të bashkive dhe drejtori ekzekutiv i shoqatës të qarqeve dhe organ tjetër është dhe drejtori ekzekutiv i akademisë. Kjo ka erdhur si nevojë e faktit se 70 % e legjislacionit të BE do zbatohet nga njësitë e vetqeverisjes vendore, sigurisht që kemi miratuar në mbledhjet e mëparshme një kuotë pjesëmarrëse që ka qënë në vlerën 800 mijë lekë të reja dhe për 3 vitet e ardhshme 50% e fondeve do mbulohen nga qeverisja qendrore ndërsa 50% nga qeverisja vendore, më të detajuar e keni në material.

Këshilltar L.Petri: Doja të dija nga ekzekutivi nëse kjo akademi që do ngrihet, u përmend nga parafolësja që do jetë me pjesëmarrje nga Bashkia, Këshillat e Qarqeve por doja të dija si është menduar në këtë marrëveshje, pesha, valenca, ne fjala vjen do pranojmë një sygjërim nga Ministria dhe kjo ka valencë më të madhe se ajo që do propozojë z.kryetar?

U përmend kryetari i Bashkisë të pakicës qeverisëse nuk e kuptova këtë, mund ta sqarosh të lutem se çfarë është?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ideja është për të ngritur një akademi e cila do shërbejë për trajnimin dhe aftësimin e burimeve njerëzore të Bashkive, kjo nevojë lindi sepse konstatohet se ka nevojë për trajnime të vazhdueshme të stafeve të Bashkive dhe trajnimet e e ofruara deri tani nëpërmjet këtyre entiteteve

shkallës, efikasitet më të mirë, cilësi më të mirë por edhe një lloj qasje pak më të plotë në rast se mund ta them këtë gjë. E para bazohet në ligj dhe e dyta nuk është se çënohet diçka, unë nuk e kam parë që në momentin që çënohet kjo akademi ne na hiqet e drejta që të bëjmë trajnime me fondet tona apo me partnerë të tjerë për burime të caktuara njerëzore, pra unë mund të vazhdoj të jem edhe anëtar i kësaj akademie dhe të bëj një listë me trajnime këtu por nuk ma heq njeri të drejtën që për x gjë në rast se ne ose Këshilli e gjykojmë se duhet ta bëjmë edhe atë do e bëjmë, nuk shoh ndonjë cënim të kompetenca tona. Përsa i përket dublimi të fushave të përgjegjësive me institucione të tjera përmendet pak ajo të themi raporti i kësaj akademie me entitetin ekzistues. Ajo aktualisht ka një modul që e ofron vetëm për nënpunësin civil dhe diçka për Bashkitë por konstaton se nuk mjafton për nevojat që Bashkitë kanë aktualisht dhe për nevojat që këto Bashkitë do të kenë në procesin e antërsimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Unë mendoj se kjo duhet mbështetur sepse po ngrihet një akademi vetëm për trajnimin e Bashkive, mendoj se është iniciativë shumë e mirë dhe duhet mbështetur. Përsa i takon modelit që është marrë nuk di ta them këtë, ka diçka në material, ndonjë referencë Anxhela? Nuk e di ta them tani sesi e kanë të organizuar vendet e ndryshme të BE jo vetëm trajnimin e kapaciteteve të pushtetit vendor.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Hapim fjalën për diskutime nëse nuk ka pyetje dhe gjatë diskutimeve mund të trajtoni diçka tjetër që lidhet me këtë çështje.

Këshilltar E.Bregu: Duke pasur parasysh se bordi drejtues do të përbëhet me shumicë nga pushteti qendror dhe një nga Universiteti i Tiranës që varet nga Qeveria 6 me 5 i bie, duke qënë vendimet do varen nga shumica e bordit drejtues besoj se këtu ka diçka që i humbet pak autonominë qeverisjes vendore dhe tjetra a do ndikojë ky organizëm në punësimet që do bëhen për shkak se duke orientuar trajnimet do orientojë edhe punësimet në Bashki.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më fal bëhet fjalë për trajnime të stafëve të Bashkive, pra është staf aktual i Bashkisë duhet të trajnohet të aftësohet nuk ka lidhje me punësimin e ardhshëm, në rast se qëllimi do ishte ky nuk ishte pse të krijohej kjo akademia për të punësuar, nuk ke si e lidh.

Këshilltar E.Bregu: Si mund të bëhet orientimi ndryshe?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: I punësimit?

Atë duhet ta thonë ata që e mendojnë këtë gjë ne nuk e mendojmë as në nivel lokal, as në nivel qendror, por kjo nuk ka lidhje. Kurse për këtë ndarje ajo është një ndarje që po ta shohësh është jo vetëm ndarje pushtet qendror, pushtet vendor por edhe universiteti si një institucion i pavarur por edhe edhe ato që janë pjesë e pushtetit qendror janë të lidhura drejt për së drejti me pushtetin vendor, pra ke edhe këtë ASP konsiderohet si përfaqësues i pushtetit qendror, ai vërtet ka varësi qendrore por është i lidhur me trajnimin, pra është në kompetencën e shkollës të trajnimit. Agjensia e Mbështetjes të Pushtetit Vendor, Ministria e Pushtetit Vendor vërtet janë entitete të Shqipërisë por janë të lidhura ngushtë me operimin pushtet qendror, pushtet vendor.

70 % e direktivave të BE zbatohen në nivel vendor, për pjesën e anëtarësimit shqyrr jemi në momentin që mund të flasim me baza reale dhe data që nuk i kemi vënë ne por BE 2027 është mbyllja e negociatave dhe pastaj është procesi brenda shteteve anëtarë të BE që të përfundojë dhe të lenë një datë, kjo është një histori aspiratash të hershme që pas rënies të komunizmit janë 20 e ca vjet që një pjesë të kohës ka qeverisur PD disa PS për mendimin tim ky është një proces që disa herë na ka afruar disa herë jo. Shqyrr jemi në këtë moment të bëjmë një trajnim më të thellë të Administratës Vendore sepse jemi në prag të antarësimit dhe 70 % do zbatohet nga kjo administratë në nivel vendor. Tani për këtë të Aspës jeni pak kontradiktorë sepse thoni nga njëra ore kompetencat pse mos bëhet më shumë në nivel vendor dhe përmendi ASP-en, ajo është një institucion që ka varësinë krejtësisht qëndrore dhe në momentin që flasim duam ta shndërojmë ASP-në me një akademi e cila do menaxhohet si subjekt i kompetencës të përbashkët, pra në drejtim të decentralizimit po ikim në drejtim decentralizus, ishte një institucion në varësi qëndrore, i kishte trajnimet të cingëra. Tjetra për pjesën sa e nevojshme është ekzistenca e kësaj akademie, trajnimi, ja u shpjegova edhe njëherë nuk ka lidhje me punësimet ka lidhje me trajnimet e stafit të bashkive ata që janë dhe ata që do jenë në të ardhmen . Meqënëse u spekulua pak me pjesën e militanzimit në raport me meritokracinë ai këndvështrimi im është që po në Bashkinë e Korçës nuk do doja të jemi 100 % meritokraci siç do e doja unë, mbase ka edhe njerëz që nuk e meritojnë dhe kjo është një formë që të trajnohen në rast se nuk trajnohen vetë ecuria dhe sfidat që do ketë pushtetit vendor për shkak të procesit të antarësimit do i nxjerrë jashtë loje, këtë pjesën e militantizmit në raport me meritokracinë janë bërë hapa shumë të rëndësishëm nga Qeveria Shqiptare që ta sanksionojë edhe me ligj të jenë edhe detyrime kjo pjesa e meritokracisë në Administratën Publike dhe ligji detyron të bësh ca gjëra, përshembull portal në arsim nuk ka qëndër dhe unë e të dua nuk ndihmoj dot. Tani këtë këtu kur e ngrini me forcë, me forcë mund ta ngrerë dikush i ndonjë partie të re, ose ndonjë këshilltar i pavarur që nuk ka qeverisur ndonjëherë në Shqipëri , pretendoni se në kohën kur e qeverisnit ju Bashkinë ishit në nivele shumë të larta të meritokracisë dhe në nivel 0 të militantizmit dhe nuk na takon ta bëjmë diskutimin me emra por po të doni ulemi pas kësaj dhe diskutojmë kush i ka mbajtur pozicionet dhe çfarë kualiteti ka pasur profesinoal dhe në qeverisjen tuaj dhe tonën por nuk do dalësh mirë.

Këshilltar E.Bregu: Tani ti mendon se duhet të duartrokasim ne?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Jo unë thjesht po them që nuk i takon, unë po të isha nuk do e thosha këtë shikojë këtë pjesën e meritokracisë dhe raportin me militantizmin sepse ke ikur për keq.

Këshilltar E.Bregu: Kam përshtypjen se po manipulon me këto që thua.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Z.Bregu ju lutem mos ndërhyni.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po flas me këshilltarin që e ngriti shqetësimin, perfekt nuk jemi dhe të shoh në sy kur e ngre këtë gjë por procesi dhe administrata po ikën në drejtim duke u përmirësuar këtë ta them me bindje dhe po të duash i zemë edhe me emra jo këtu dhe për sa i takon kësaj pjesës të mbulimit të një kompetence tërësisht në nivel të Bashkisë apo duke hyrë në forma bashkëpunimi me Bashki të tjera apo me Bashki të gjithë vendit siç është kjo sepse u përmend edhe ideja që u prezantua dhe për ngritjen

më shumë punë i bëj vetes time duke pasur një Administratë profesionale dhe eksperte që t'i kënaqë qytetarët me shërbimin e saj sesa të ve dike politik i cili të më shtojë 10 vota dhe të largojë 10 mijë sepse nuk bën, e kam qasje dhe besoj se e kam të drejtë. Valbonën e kam drejtoreshë të financës dhe nuk e kam larguar ta zvëndësoj me një person politik, madje nuk e di çfarë bindje politike ka nuk e kam pyetur, atë zonjën që ishte para pak kohësh drejtoreshë e prokurimeve tani u largua me dëshirën e saj, e kam gjetur tek prokurimet, drejtoreshën e urbanistikës e kam gjetur nga administrata e mëparshme derisa doli në pension, nuk kam pasur ndonjë tendencë për fshesë, por nga ana tjetër e ke gabim kur thua Administrata po të kalojë disa vite nuk mund të përmirësohet e ke në koncept gabim. Statusi i nënpunësit civil që ne e kemi marrë si detyrim nga Europa dhe e kemi pjesë të detyrimeve që i kemi firmosur si pjesë e anëtarësimit në BE statusi synon pikërisht këtë gjë të mbrojë Administratën nga lëvizjet politike pra dikush të ketë një pozicion dhe në rast se performon të ketë mundësi të bëjë karrierë në Administratë, duhet të mësojnë sepse sfidat nuk janë të njëjta si sot edhe para 20 vitesh ne para 20 vitesh nuk e kishim fare këtë anëtarësimin në BE por sot jemi në këtë moment pas 15 vitesh mund të kemi sfida të tjera duhet gjithë kohën të trajnohesh. Ju mund të ngrini një pikëpyetje sa cilësore do jetë Akademia në trajnime këtë mund ta spekuloni.

Këshilltar D.Osmani: Çfarë do trajnojë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Stafin që është dhe ata që do vijnë dhe koha do ta sjellë këtë gjënë që kush nuk trajnohet do dalë por jo për arsye politike por për të kundërtën, për meritokracinë edhe këto doja të thoja dhe më nuk flas për këtë pikë.

Këshilltare A.Përmeti: Përshëndetje, unë do sjell pjesën këndvështrimit dhe eksperiencës time, duke qënë se kam punuar 18 vjet në një bankë Gjermane e cila bazën kishte standartizmin, trajnimin e vazhdueshëm të stafit, mund të them se ajo kishte Akademi Qëndrore, Rajonale dhe pjesën e qëndrave të trajnimit në çdo shtet dhe arsyeja ishte të siguronte një standartizmit të stafit, një ngritje përditësim të njohurive dhe në fund përkthehej me një shërbim shumë të mirë ndaj klientit, e sjell këtë në paralelizëm sepse iniciativa për krijimin e kësaj akademie nuk është sot, nëse ne e lexojmë materialin shpejgues, e ka shumë të qartë kur megjithatë sepse informohen personalisht edhe me këtë ecuri dhe kapituj që hapen për negociim, mund të them pjesa e kapitullit të parë që janë themelore hyn edhe administratë dhe territori dhe në pjesën e kësaj hyjnë rregullat dhe ligjet që ekzistojnë në Europë janë parë sesi janë dhe si bashkohen në Shqipëri dhe është parë e nevojshme që administrata ka nevojë. Aspa nuk do e krahasojmë me këtë akademi pasi nuk realizon dot disa trajnime të standartizuara, pasi academia vjen si një Bashkim i një institucioni me kompetencë të përbashkët që ja lejon ligji dhe unë hyra e lexova është ligji 14 për vetëqeverisjen vendore 139, 17 dhjetor 2015 dhe aty sa herë ne kemi pikëpyetje si këshilltarë mund të hyjmë aty, Kjo pjesë thuhet se ka erdhur në disa etapa, ne kemi miratuar edhe në buxhetin e Bashkisë në kuotën 800 mijë lekë, është miratuar që vjet për gjitha Bashkitë pjesa e kuotës të pjesëmarrjes, gjithashtu çfarë standartizon kjo akademi dhe thueht cilësisht se asnjë nga këto trajnime apo kurikula nuk do zvëndësojë kurikula që ka ASPA por do i ketë më të përmirësuar, duhet që vazhdimisht të trajnohet pasi trajnimi është përshtatja me standartet e reja, me gjuhën sepse duhet të dish dhe gjuhë që disa gjëra t'i kuptosh. Trajnimi bëhet për administratën dhe ajo

them me përgjegjësi se nuk e di fare se kush janë ata individë që unë emëroj si edukatore. Procedura është shpallet vendi vakant, drejtoresha na lajmëron ne ne shohim portalin kush është i pari më bën kontratën Anxhela unë ja firmos, as e njoh fare kush është, kaq.

Këshilltar E.Bregu: Keni bërë masakër në 2013 prandaj.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem këshilltarëve të ruajnë qetësinë dhe përqëndrohen tek rendi i ditës. Diskutime të tjera nuk ka, e hedhim në votim kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 24

Vota KUNDËR 2

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 24 pro, 2 kundër, 1 abstenim.

Pika 8 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT PËR RININË NË BASHKINË KORÇË (2025-2028)”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem komisioni.

Këshilltare A.Taho: Kemi një bashkëpunim midis Bashkisë Korçë dhe Qendrës për të Drejtat e Fëmijëve në bashkëpunim edhe me Agjensinë Kombëtare të Rinisë dhe Ministrin të Shtetit për fëmijë një plan i cili ka për qëllim nxitjen e të rinjve për të ndërmarrë veprime në jetën sociale, ekonomike, politike të Bashkisë shihen qartë në plan përfshirjen e të rinjve edhe në çështjet sociale dhe politike të qytetit. Është bërë para disa ditësh edhe konsultimi publik ku një pjesë e anëtarëve kanë qënë prezent, ka pasur edhe aktorë të tjerë, komisioni ka vendosur t’ja kalojë këshillit për miratim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, unë do doja që gjatë konsultimit u bënë edhe rekomandime u përmbledhën në një material dhe ju dërguan përsëri aktorëve për ta reflektuar në plan. Unë do doja t’ja jepja fjalën edhe njëherë personit përgjegjës z.Dejvi Hoxha i cili do bëjë edhe një pasqyrë se cilat prej rekomandimeve janë përfshirë në plan dhe cilat nuk janë përfshirë.

Ekzekutivi D.Hoxha: Përshëndetje këshilltarë, përshëndetje kryetar planin e përmbledhi shumë mirë Anxhela me të gjitha prioritetet dhe ata që e kanë trajtuar, nuk e di nëse është nevoja t’i lexoj përsëri prioritetet por besoj se materiali është i plotë dhe i kuptueshëm. Në lidhje me atë që znj.kryetare tha rekomandimet janë shtuar sipas prioriteteve në pjesën e punësimit dhe sipërmarrjes janë shtuar intershipe për të rinjtë pa eksperiencë pune, kurse falas në IT, menaxhimin e rrjeteve sociale, panaire karriere. Tek prioriteti i pjesëmarrjes rinore është zbatimi manual i këshillave rinor vendor, raportimi publik i këshillit rinor vendor mbi rekomandimet të marra nga Bashkia dhe gjithashtu ambasadorë e rinisë në fusha të ndryshme, sipërmarrje, teknologji. Po ashtu në pjesën e arsimit është pjesa e laboratorëve sten e klasave dixhitale për shkolla dhe universitete që aktualisht është duke ndodhur. Transporti falas për nxënësit nga zonat rurale dhe gjithashtu promovimi profesional për të rinjtë. Tek

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kërkoj ndjesë.

Këshilltar K.Pllaha: Patjetër që mund të kemi ky është një dokument strategjik që jep vizionin e Bashkisë ndaj të rinjve por është edhe një plan veprimi ku tregon cilat janë etapat që do ndërmerren gjatë këtyre viteve dhe çfarë rezultate do kenë, nuk është e pritshme që do realizohet 100% gjërat ndryshojnë, do ketë ndryshime por duhet bërë një mënyrë monitorimi, që në fund të 3 viteve të dimë cilat pika janë realizuar, cilat jo por pa pasur indikatorë të matshëm kjo gjë nuk mund të bëhet, përfshirë edhe këtu faktin e rekomandimeve që janë përfshirë rishtazi. Kam kërkuar në konsultimet publike 1 raport për planin e mëparshëm të veprimit dhe ajo merret si një bazë e mirë tek ky raport, për të parë sa është realizuar ky plan dhe cilat pika kanë dështuar. Gjithashtu kam kërkuar nuk e di cila ishte organizata që merrej me këtë pjesë që e menaxhonte qëndrën rinore me një ndalesë që për hir të së vërtetës nuk e dija që ekzistonte, nuk e dimë sa ka funksionuar, çfarë kërkesa ka menaxhuar të të rinjve e kam kërkuar dhe nuk na është vënë në dispozicion si këshilltarë.

Këshilltar J.Deli: Qendra Rinore me një ndalesë është shoqatë jo pjesë e Bashkisë.

Këshilltar K.Pllaha: Nuk mendoj se mund të përfshihet në planin rinor si një arritje, e treta një nga pyetjet që unë shtroj është si subvencionohet biznesi për të rritur punësimin e të rinjve?

Një sygjërim që unë kam dhënë është që Bashkia të mbulojë për një periudhë përsëmbull 6 muaj mbulimin e sigurimeve shëndetësore për të rinjtë që stimulohen për herë të parë në bizneset e vendit sepse për ndryshe çfarë interes do kishte një kompani që qoftë me interesin tuaj si Bashki të punësonte të rinj të pa kualifikuar, kjo është një skemë që mund të ishte pjesë e planit duke u realizuar hap pas hapi, pyetje tjetër është sa është buxheti që kërkojnë gjitha këto tek ky plan vit pas viti për tu realizuar sigurisht që ka një kosto financiare dhe Qendra Rinore do duhet t'ja kërkojë kryetarit vit pas viti si buxhet për të realizuar gjitha veprimet. Ky plan veprimi nuk trajton një nga problematikat që është largimi i të rinjve nga vendi, pra a do ketë një zgjidhje që stimulon qëndrimin e të rinjve, një mënyrë do ishte një program për të incentivuar kthimin e të rinjve qoftë për prioritetë punësimi për ata që vijnë nga univeristete ndërkombëtare apo për lehtësi fiskale për ata që kthehen në Korçë për të hapur një biznes. Karta e studentit që u relalizuar në bashkëpunim me universitetin a mund të shtrihet për gjithë grupmoshën rinore dhe çfarë shërbime mund të ofrojë ajo ?

Përfshirë këtu edhe atë që tha z.Bregu transporti nga zonat rurale në qytet për të pasur akses në kurset e Qytezës të Fëmijëve apo në ambiente të tjera që janë arritje dhe në shërbim të rinisë por duhet t'ju japim akses edhe të rinjve nga zonat rurale dhe në plan-veprimi shikojmë që një pjesë e programeve priten të financohen nga organzaita të huaja. Nëse ato nuk kanë mundësi t'i financojnë pezullohet kjo gjë apo do ketë një kosto shtesë për Bashkinë?

Pyetja tjetër lidhet me aktivizimin e të rinjve në vendimmarrjen nmarrjen në Këshillin Rinor i cili gjatë këtyre viteve nuk di të ketë sjellë ndonjë nismë mbase lidhet me kryetarin e Bashkisë, unë do prisja më shumë angazhim prej tyre, si do i angazhojmë, mbase u zgjata pak por është çështje me rëndësi.

z.drejtor si i bëhet pastaj, ka një paqartësi nga 1 anë thuhet do votohet pikë pas pike, nga ana tjetër ne do miratojmë dhe zbardhim mbledhjen e radhës.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Unë kam gjëra të tjera por një pjesë lidhet e ato që thatë, pra e para unë bie dakort që ky plan i rinisë përtej përcaktimeve që janë aktualisht dhe mund të jenë bërë dhe ndryshime gjatë dëgjësive ku mund të shtohen apo hiqen përsëri nuk është i plotë në sensi që mund të dojë plotësim me masa dhe buxhete konkrete për secilën masë bie dakort me këtë gjë. Me atë që po thotë Joani dokumenti është përgatitur me mbështetje të Agjensisë Kombëtare të Rinisë që ka angazhuar një organizatë si CRCA dhe me ndërveprim me Bashkinë ka erdhur ky dokument. Joani thotë se kjo organizatë në kuadrin e projekteve të tjera është e gatshme t'i bëjë update palnit duke shtuar buxhetimin, objektiva më të detajuara. Ajo që unë propozoj është kjo me të drejtë këshilltarët duhet të dinë si do reflektohen këto në dokumentin që do miratojmë. Këto vërejtjet që janë bërë në dëgjesa dhe ne kemi rënë dakort t'i pranojmë duhet të thuhet do miratohen me këto 1,2,3 pika me dakortësinë që dokumenti nuk po e konsiderojmë të mbyllur, duhet vënë objektivat më të detajuara dhe buxhete specifike, mund të jetë kjo si zgjidhje?

Të ta them edhe njëherë dokumentin që ju prezantohet sot do saktësohet cilat janë sygjërimet që ju keni bërë dhe ju me të drejtë i doni por nuk mund ta dërgojmë në trajtën e objektivave apo buxheteve sepse kjo kërkon kohë. Organizata ka thënë jam e gatshme por duhet të ketë akses diku tjetër. Pra ta miratojmë dokumentin në sensin e detajimit pa bërë detajime të mëtejshme duke saktësuar ndryshimet dhe t'i japim vetes kohë dhe ti kemi sa më të detajuara sepse unë bie dakort duhet t'i kemi sa më të detajuara të jetë dhe më i monitorueshëm në zbatimin e tij.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Meqënëse Dejvi ka një material të integritetit të rekomandimeve në plan t'ja u shpërndaj ato rekomandime që përfshihen apo jo dhe ato që Klajdi propozon të shkruhen në material dhe t'i jepen Agjensisë.

Këshilltar K.Pllaha: jo.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Çfarë kërkonin ju ?

Këshilltar K.Pllaha: Nuk më pëlqen të bëhen gjërat hajd se duhen bërë, janë gjëra serioze plan rinie ku të gjithë bien dakort që duhet bërë, duhet bërë mirë . E para ajo organizata nuk e di nëse e kishit kontaktuar ju apo jo por nuk mund të bëjë një punë shkel e shko është merr ca të dhëna nga Plani Strategjik Kombëtar dhe hidhi në Korçë ai do një studim të mirëfilltë nuk ka nevojë për projekt tjetër por i kthehet dhe i thuhet bëjë siç duhet ta miratojmë siç duhet.

Këshilltar J.Deli: Për pjesën e organizatës nuk po e mbroj por e ka bërë në nivel qarku dhe çdo Bashki ka organizuar workshop të ndryshme për të marrë të dhëna, workshop ka zhvilluar në Korçë ka qënë prezent Këshilli Rinor, aktorë të ndryshëm, këshilltarë dhe pjesëmarrës nga universiteti apo gjimnaze me përfaqësues si qeveria e nxënësve apo këshilli studentor ku janë bërë këto punëtori dhe janë mbledhur të dhëna ato që vetë të rinjtë kërkonin. Plani i Korçës ka 5 priorite ndryshe nga ai i Pogradecit ku ka 4 përshembull se në varësi të pozitës gjeografike, turizmit apo elementë të tjerë që Bashki të ndryshme

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nuk morët leje, ndërkohë fjala për znj.Taho.

Këshilltare A.Taho: Më vjen keq që këtu po paragjykojmë çdo kompani apo organizata trajnimi sikur nekëtu në Këshill jemi më të mirët, ndërkohë nuk e njohim fare stafin e Bashkisë dhe asnjë tjetër. Po flasim për 1 çështje të rëndësishme ku drejtori dhe kolegu i tij na foli sesi janë realizuar, në dijeninë time kanë qënë edhe të rinj që kanë dhënë mendimet e tyre pro. Ne sot jemi duke miratuar idetë e të rinjve që ndoshta problemet i dinë më mirë se ne, se çfarë duan jo në çdo pikë të rendit të ditës duhet të bëjmë politikë por duhet të japim ide dhe unë e vlerësoj shumë Klajdin që ka qënë prezent në dëgjesat e planeve dhe ka dhënë ide që thanë do i reflektojnë, kështu që kemi mundësi që gjatë muajve të ardhshëm pavarësisht moshës të japim ide, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjala për z.Petri.

Këshilltar L.Petri: Do sygjeroja kur bëhen plane lokale veprimi siç është kjo për rininë të përfshihej dhe universiteti sepse jemi qytet universitar dhe ka specialistë të mirë.

Këshilltar J.Deli: Ka qënë këshilli studentor.

Këshilltar L.Petri: Po në çfarë mase se ju po thoni e bëri shoqata?

Këshilltar J.Deli: Shoqata krijoi punëtorinë.

Këshilltar L.Petri: Z.Kryetar po them t'i kërkon ndihmë nuk është turp t'i kërkon ndihmë universitetit duam të bëjmë plan lokal na ndihmoni.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Plani është mbështetur nga Agjencia Kombëtare e Rinisë e cila ka përzgjedhur CRCA si organizatë që do merret me këtë punë dhe nuk na i la ne dhe ne zgjedhem CRCA dhe jo universitetin. Nga ana tjetër CRCA ishte përgjegjëse që këtë plan ta përshtatë me realitetin lokal, të ftonte aktorë lokal, rini lokale ka bërë 2 workshope nga universitet ka qënë këshilli studentor mbase mund të ishte ftuar dhe universiteti si institucion të jepte opinionin e tij në kapacitete akademike në këtë sens jo në sensin e të riut.

Këshilltar L.Petri: Këtë nënkuptova edhe unë përfshirja e universitetit në studim akademik.

Këshilltar D.Osmani: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mos ndërhy sepse po flet kolegu.

Këshilltar L.Petri: Këtë kisha si sygjërim, jam i mendimit që edhe procedura ka rëndësi pa hedhur poshtë punën e mirë si për përpilimin e planit apo edhe motivimin për të patur këtë gjë, nuk duhet ta konsiderojmë thjesht si një kërkesë të ardhur nga lart dhe duhet zbatojmë është e udhës të merret

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 1

Vota ABSTENIM 4

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 22 pro, 1 kundër, 4 abstenim.

Pika 9 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2025-2030.”

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Komisioni ju lutem.

Këshilltare A.Taho: Plani për barazinë gjinore është përgatitur nga drejtoria sociale në Bashki në bashkëpunim me organizatën joqeveritare UNDP dhe në këtë plan institucionet, organizatat jofitimprurëse në Bashkinë Korçë kanë dhënë në dijeninë time gjatë takimeve që kam qënë të shumta për të hartuar këtë plan, të cilin në konsultimin e fundit nuk pati asnjë rekomandim, organizatat dhe aktorët ishin në pritje për realizmin e këtij plani. Qëllimi është garantimi i të drejtave dhe barazisë për gjithë qytetarët duke siguruar mbrojtje, integrimin shoqëror të tyre.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Në dijeninë time në takimin e zhvilluar Eda si nënkryetare e Këshillit e ka ndjekur dhe nuk ka pasur sygjerime apo rekomandime gjatë procesit, për informacion shtesë ja japim fjalën drejtoreshës.

Drejtoria e Kujdesit Social M.Jorgji: Plani për barazinë gjinore 2025-2030 u hartua nëpërmjet një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës në bashkëpunim me organizata shoqëri civile, institucione publike vendore, këshillin vendor rinor, aleanca e grave këshilltare dhe anëtarë të këshillit. Në kuadër të projektit BE për barazinë gjinore, baza ligjore ku u bazua hartimi është Strategjia Kombëtare e Barazisë gjinore 2021-2030 si dhe Karta Europiane për barazim të burave dhe grave në jetën vendore e cila është e miratuar edhe nga Bashkia Korçë. Katër janë fushat e ndërhyrjes:

- Promovimi i të drejtave ekonomike dhe sociale të punësimit dhe fuqëzimi i vajzave dhe grave në gjithë diversitetin e tyre.
- Rritja dhe përfaqësimi i të rejave dhe grave në vendimmarrje politike në nivel vendore, liri nga gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave.
- Integrim gjinor i politikave vendore.

Ky plan ka edhe objektiva disa janë: Rritja e aksesit të grave dhe të rejave në gjithë diversitetin ndaj shërbimeve, burimeve financiare që ndikojnë në fuqëzimin dhe përmirësimin e situates ekonomike, rritja e pjesëmarrjes politike në nivel vendor për gra edhe të reja, fuqëzim apo rritje të efikasitetit të mekanizmit kundër dhunës në familje, zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktika të ndryshme të disavantizimit të shumëfishtë përmes edukimit të shoqërisë me parime të ndryshme gjinore, fuqëzimi i grave për krijimin e komuniteteve të sigurta, rritje e përgjegjshmërisë dhe transparencës të Bashkisë në angazhime politike për integrim gjinor dhe

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ky plan ishte njëri prej dokumentave që është parashikuar të shqyrtohej edhe të votohej, ishte një draft i përgatitur me mbështetjen e shoqatës të Bashkive e cila caktoi një grup ekspertësh për tu marrë me hartimin e këtij plani, nga procesi i konsultimeve publike nga informacioni që mora rezultoi që kishte disa pika të rëndësishme në këndvështrimin tim edhe disa vërejtje, kërkesa dhe rekomandime të cilat qëndronin dhe duhet të jenë pjesë e planit dhe ishte e pamundur që ekspertët t'i plotësonin brenda 3-ditësh. Prandaj në këtë rast kam kërkuar që dokumenti t'ju rijepet bashkë me vërejtjet e dala nga kërkesat dhe vërejtjet tona të brendshme me qëllim që kur të jetë më i plotë dhe të jenë reflektuar dhe rekomandimet dhe kërkesat, do vijë në një moment të dytë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit z,kryetar, pika 10, ju lutem komisioni nëse është mbledhur.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Nuk kishte kourum.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ekzekutivi një sqarim.

Drejtorja Juridike A.Qeramixhi.Dishnica: Miratimi i procedurës për përfitimin e bursave ka erdhur si pasojë e një situatë të krijuar vitet e fundit por që është përkeqësuar kryesisht gjatë viteve shkollore 2023-2024 dhe 2024-2025, ku numri i aplikimeve për bursa ka qënë rreth 600-700 aplikime për vit shkollor dhe bursa të miratuara nga Ministria e Arsimit kanë qënë vetëm 350 në këto kushte ka lindur nevoja që ne të miratojmë një paketë dokumentacioni dhe një procedurë të caktuar që vijnë në Bashkinë Korçë sigurisht që edhe më parë i kemi marrë në shqyrtim kërkesat bazuar në një dokumentacion por ajo që ju paraqesin në këtë material është një dokumentacion i reduktuar jo se dokumentacioni nuk nevojitet por është një dokumentacion që e gjejmë vetë në zyrat e tjera të Bashkisë, dokumentacionin e vërtetimit të paaftësisë përshembull ne ja kërkonim personit të na i sillte vetë tani mund ta marrim nga drejtoria e kujdesit social, po kështu edhe dokumentin që ka lidhje me punëkërkesin e papunë edhe këtë mund ta marrim tek drejtoria e kujdesit social sepse ky aplikant përfiton edhe ndihmën ekonomike. Kjo për sa i përket dokumentacionit ndërsa për sa i përket procedurës kemi menduar se gjithë dokumentacioni do paraqitet pranë drejtorive të shkollave dhe drejtorët e shkollave apo personat e caktuar prej tyre do e mbajnë gjithë dokumentacionin nga ana formale dhe do mbahet me një procesverbal me datë dhe me orë të nënshkruar nga pranuesi i dokumentacionit edhe nga prindëri ky dokumentacion do dorëzohet në Ndërmarrja Mbështetëse e Arsimit sërish me procesverbal me datë dhe orë ky një komision i ngritur nga drejtori do verifikojë dokumentacionin jo vetëm nga ana formale por edhe nga përmbajtja, ajo që ne kemi parashikuar si pjesë e procedurës aplikantët që përfitojnë bursë sipas kuotës të parashikuar nga Ministria do jenë 350 të parët që kanë aplikuar prandaj është gjykuar mbajtja e procesverbalit me orë dhe datë. Dua të them edhe diçka që ky relacion është hartuar edhe në konsultim me komisionerin e mbrojtjes nga diskriminimi për shkak sepse kemi qënë objekt i disa procedimeve administrative të kryera pranë këtij institucioni dhe gjitha rekomandimet janë reflektuar në material.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje?

Këshilltar K.Pllaha: Nëse e kuptova drejt vite më përpara ne vendosim një kuotë bënim shtesa kurse këtë vit është vendosur se do jenë vetëm 350 të parët që aplikojnë?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 25

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 25 këshilltarë, 25 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 11 e rendit të ditës.

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË BASHKISË KORÇË NR.185, DATË 28.12.2022, PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TAKSI NË BASHKINË E KORÇËS.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Besoj edhe këtu komisioni nuk është mbledhur, një përmbledhje ju lutem nga ekzekutivi.

Ekzekutivi N.Lika: Bëhet fjala në lidhje me kërkesën që ka një subjekt që është licensuar tani me mjete elektrike taksi kilometer 0 të rregjistruar dhe u pajis me dokumentacionin përkatës dhe ka fituar veprimtarinë me pretendimin për të pasur një vend për taksi, kërkesa e tij lidhet me një vend shumë të përshtatshëm për të pasur shërbimin taksi në hyrje të Pazarit ngjitur me Hanin e Pazarit por ato vende janë miratuar si parkim me pagesë dhe këto vendime janë me vendim Këshilli, e gjykojmë të arsyeshme t'ju jepet ky vend pasi shërben shumë për qytetarë dhe vizitorë si shërbim i parë me mjete elektrike ta kishte një stimul të tillë, ky është propozim i përgjithshëm.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Pra një vend parkimi nga ato.

Ekzekutivi N.Lika: 3 vend parkimi në total, të lincsuara ka 3 automjete, pretendon të shtojë edhe 2 të tjera kërkesa është për 4 por ne mendojmë të arsyeshme këto 3 vende duke qënë se mjeti është gjithnjë në lëvizje.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar L.Petri: Ky stimul që pretendohet t'i bëjmë zotërisë që ka sjellë këtë risi me taksi elektrike, i hyn dikujt tjetër një pjesë, atje është parkim me pagesë?

Sa është kostoja që kryetari i Bashkisë nga ky parkim me kujdes dhe sa do jetë nëse ndihmojë zotërinë?

Ekzekutivi N.Lika: Llogaritur në formën e përgjithshme sa është koeficienti i shfrytëzimit, maksimalisht duke patur parasysh tarfiën 50 lekë në orë dhe 8 orë që është parkimi, një vend parkimi ditor është në nivelin 400 lekë. Në fakt shfrytëzimi kështu është teorik, lidhur me totalin e të ardhurave që lidhet nga parkimi me pagesë, shfrytëzimi kalon në nivelin 30-40% duke pjestuar në total për gjithë vendet e parkimit, shtojmë edhe disa hollësira të tjera ku vijnë periudha me shira, ngrica përjashtohen ditë të

Këshilltar K.Pllaha: Kur unë të jem në vendin tuaj do bëj një parkim nëntokësor me dy kate atje tek sheshi i Pazarit dhe kjo është e zgjidhshme.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Edhe investitori e kuptoi edhe qytetarët kuptuan zgjidhjen tuaj.

Këshilltare A.Përmeti: Kam dy pyetje të shkurtra, e para njëherë sepse nuk e kam informacionin është detyrim i Bashkisë në momentin që licenson një operator ta percaktojë në këtë vend do jetë me post? Ekzekutivi N.Lika: Jo.

Këshilltare A.Përmeti: Pyetja tjetër duke qënë se kjo është risi për Korçën dhe trendi është kur hyn dikush me një risi do ketë të tjerë që do ndryshojnë makinat dhe kjo është shumë mirë. Postet do jenë për kohë taksi apo për të gjitha?
Sot nëse shkon dikush tjetër me taksi joelektrike nuk lejohet?

Ekzekutivi N.Lika: Jo.

Këshilltare A.Përmeti: Tani kam dy komente e para njëherë e përgëzoj kompaninë që ka sjellë këtë risi unë e kam parë dhe kam thënë ç'është kjo makinë, ka hapur edhe një kërkesë për vend pune kush është interesuar dhe kjo është gjë e mirë dhe tjetra nëse shtohen do kemi ulje të dioksidit të karbonit, përmirësim të jetesës, ulje të ndotjes dhe mbase reduktim të këtyre taksive të vjetra.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ta hedhim në votim?

Këshilltar L.Petri: Do bëjmë diskutime apo do e mbyllim?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Z.Pllaha bëri diskutime, pyetje ndaj.

Këshilltar L.Petri: Nisur nga fjala e z.kryetar, do thoja që risia në fushën e makinave elektrike tani është trend botëror dhe është për tu përshëndetur që ka sipërmarrës që futen në këtë drejtim edhe unë e kam parë mjetin në fjalë dhe kam hequr kapelen por kjo nuk do të thotë që një arritje e biznesit të shtohet si arritje e qeverisë vendore. E dyta më duket si procedurë që vjen zotëria takon z.kryetar dhe i shtrohet tapeti i kuq që po mo do ja, këtu e kam jo se ne z.kryetar jemi kundër qasjes ekologjike.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: E para njëherë unë nuk mora asnjë meritë, ku e dëgjove ti që thashë se këtë investitorin e solla unë, unë thashë këtij investitori që po investon, që po merr këto risje edhe këtë investim e ka në përputhje edhe me vizionin tim edhe me vizionin tonë, t'ja lehtësojmë dhe plotësojmë kaq gjë që mundemi, unë nuk thashë e solla unë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Heqja e asaj kjoskës është bërë në kuadrin e asaj për të liru hapësirat publike, unë nuk thashë që e ke vënë me forcë. Përsa i takon mundësive të tjera duhet ta shoh se çfarë mundësi punësimi mund të kemi ne, por heqja e saj është bërë në kuadrin e lirit të hapësirave publike. Stacionet urbane nuk janë pjesë e Bashkisë menaxhohen nga kompania private që ka investuar edhe stacionin bashkë me pikën e shitjes, për atë mund të flasim nëse ka ndonjë vend të lirë sepse nuk e kam idenë.

Këshilltar K.Pllaha: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Është tjetër gjë kjo që po thua, situata aktuale është se këto stacione me pikë shitje nuk janë investuar nga Bashkia por nga një investitor privat, nëse ka ndonjë të lirë t'ju themi atyre, në të kundërt të shohim çfarë mundësi do ketë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka një kërkesë nga znj.Violeta Gjonaj nuk e di nëse është këtu por jam e detyruar të lexoj kërkesën e saj: Drejtuar Këshillit Bashkiak, për dijeni kryetarit të Bashkisë: Unë kërkuesja Violeta Skënder Gjonaj i datëlindjes 20.04.1960 banuese në qytetin e Korçës, Lagjia 1 Maji,objekti nr.1, hyrja-2, kati i tretë, apartamenti 3 parashtroj lutjen time si më poshtë banorët e pallatit me shpenzimet e tyre i kanë veshur muret me material termoizoluese unë në pamundësi financiar, me pension minimal e vetme në çertifikatë familjare do doja të mbështetesh për të bërë këtë pjesë suvatimit për të ruajtur uniformitetin e pamjes të pallatit, shpresoj kërkesa ime të merret parasysh, ka bashkëlidhur edhe fotot.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ndërhyrjet në banesat me bashkëpronësi janë detyrim i pronarëve por ne kemi filluar projektin e madh për termoizolim të pallateve në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit kur të jetë thirrja e rradhës do bëjmë aplikimin e rradhës dhe do e shohim edhe këtë kërkesë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kërkesa e fundit është e znj.Rabian që të thirret pronari i banesës tjetër ku ajo pretendon se nuk banon, ne nuk e detyrojmë të vijë me zor.

Qytetaria: Duhet thirrur nga vetë institucioni sepse unë po vuaj me atë fëmijë aty.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Herën e fundit Mirela e kemi lënë që do i bëjmë një shkresë familjes të paraqitej në Bashki edhe të paraqesë situatën e saj.

Drejtorja e Stehimit Social M.Balli: Nuk e di për cilën familje bëhet fjalë sepse ajo vetëm aludon.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: E kemi lënë dhe më vjen keq që nuk e kemi bërë këtë gjë, duhet të vinte nga sekretaria e Këshillit.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: E kemi diskutuar edhe me znj.Rabian kryetar dhe i kam kërkuar të sillte një shkresë për të identifikuar se për cilën familje bëhet fjalë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Atë familjen ku venë këta të Këshillit, atëherë të lutem sepse jam lodhur me këtë histori, më vjen keq që nuk është bërë gjë, rradha është kjo sa të mbarojë mbledhja do bësh një kërkesë me shkrim bëhet fjalë për apartamentin x, hyrja kaq ti si kërkuese të tipit kërkoj verifikimin e

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Edhe unë mendoj se dikush që nuk banon nuk ka pse e mban atë banesë, por ligji, ligj, ta lemë kështu të verifikohet edhe njëherë baza ligjore me praninë edhe tuajën si këshilltarë kush ka interes të bëjë diskutimin mbi bazën ekzistuese, e dyta kemi kemi ne hapësirë ta modifikojmë një pjesë ta hapësirës ligjore që është kontrata me vendim Këshilli dhe të përcaktohet në rast se nuk banon për një periudhë kohore nuk e di se sa dhe se si verifikohet ky fakt, nëse kemi mundësi ta ndërpresim kontratën, po bëhet dhe ne jemi të gatshëm t'i hyjmë kësaj vendimmarrje në Këshill.

Këshilltar E.Nexhipi: Unë doja pavarisisht këtij rasti, kjo duhet studiuar mirë dhe të jetë për gjithë fondin e banesave sociale me qira, të bëhet verifikim i plotë sepse nëse ne kemi dhënë këto banesa për ti pasur dikush banesa verore këto do jetë shumë e rëndë, ka element si enrgjia, uji që verifikohen. Rabiani këtë punë ka thotë ke 2 vjet nuk ke folur për mua, kur unë e kam pritur dhe përcjellë në zyrë, nuk na shqetëson Rabiani por fenomeni, nëse ka banesa me qira sociale që nuk jetohet atje nuk është normale.

Këshilltare S.Dinellari: Një pyetje të drejtpërdrejtë me znj.Raban sepse kemi disa muaj diskutojmë çështjen e saj, qëllimi juaj është që ju nëser të shkoni tek kjo banesë?

Sepse unë ndaj të njëjtin mendim si znj.Ada po e trajtojmë çështjen si personale, ju tha edhe kryetari edhe drejtoresha në rast se kjo banesë lirohet nesër ju do i nënshtroheni sërish procedurave të aplikimit, ju na sillni në mënyrë të vazhdueshme të njëjtën banesë dhe thoni se ka edhe tre të tjera paralelisht, nuk është çështje e Këshillit apo Bashkisë të diskutojë për çështje personale. Ky është një fenomen tjetër që ne merremi me individin jo me rastin e banesave me qira, ju doni atë banesë por duhet të dini se do t'i nënshtroheni të njëjtat procedurave për aplikim për banesat me qira dhe duhet të plotësonië kriteret, e kuptoni këtë gjë?

Po flas për banesën, kushtet tuaja i dimë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Do zbatojmë ato sygjerime që dha kryetari dhe këshilltarët dhe kaq. Faleminderit këshilltarë për mbledhjen e sotme, takohemi mbledhjen e radhës!

SEKRETARE E KËSHILLIT EVA NAÇI



KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK ANA VERUSHI

